KUSHTET E PËRGJITHSHME TË AFARIZMIT TË BANKËS EKONOMIKE

PËRMBAJTJA

1.0. QËLLIMI 4
2.0. FUSHËVEPRIMI 4
3.0. PËRDORIMI I LLOGARIVE 4
3.1. Llojet e llogarive 4
3.1.1. Llogaria rrjedhëse 4
3.1.2. Llogaria me shërbime bazike 4
3.1.3. Llogaria e kursimit 4
3.1.4. Llogaria rrjedhëse për fëmijë 4
3.1.5. Llogaria e kursimit për fëmijë 4
3.1.6. Llogaria Flexi Depozit 4
3.1.7. Llogaria e depozitës me afat 4
3.1.8. Interesi në mjetet e depozituara, norma efektive e interesit dhe tatimi në burim 4
4.0. PERSONAT E AUTORIZUAR 5
5.0. SHËRBIMET DHE PRODUKTET BANKARE ELEKTRONIKE 5
5.1. E-banking 5
5.2. SMS Mbushja 5
5.3. SMS Info 5
5.4. SMS Njoftimi 5
5.5. Pasqyra e llogarisë 5
5.6. Ofertat speciale 5
5.7. Shërbimi i investimit në instrumentet financiare brenda dhe jashtë vendit për klient 5
6.0. DEBIT DHE KREDIT KARTELAT, SI DHE TERMINALET POS dhe ATM 5
6.1. Debit Kartelat 5
6.2. Kredit Kartelat 5
6.3. ATM 6
6.4. POS terminalet 6
6.5. Njoftimi për humbje, vjedhje apo shfrytëzim të paautorizuar 6
7.0. TRANSAKSIONET NË LLOGARI 6
7.1. Paraja e gatshme 6
7.2. Këmbimi i valutave 6
7.3. Urdhërpagesat 6
7.3.1. Transferet brenda bankës 6
7.3.2. Transferet vendore 6
7.3.3. Transferet ndërkombëtare 6
7.3.4. Refuzimi i transfereve 7
7.3.5. Urdhërpagesa automatike (Standing Order) 7
7.3.6. Pagesat e faturave (Tax) 7
7.3.7. Kos Giro 7
7.3.8. Debitimi Direkt 7
7.3.9. Anulimi i urdhërpagesave 7
7.3.10. Procesimi i pagave dhe pagesave masive 7
8.0. PRODUKTET KREDITORE 7
8.1.1. Instrumentet e sigurimit të produkteve kreditore 8
9.0. URDHËRAT NGA AUTORITETET LOKALE 8
10.0. TARIFAT DHE PROVIZIONET 8
11.0. PRIVATËSIA DHE TË DHËNAT PERSONALE 8
12.0. PRONARI KRYESOR PËRFITUES 9
13.0. MBYLLJA E LLOGARISË 9
13.1. Mbyllja e llogarisë së Klientit - ndërprerja e shërbimit-/eve 9
13.2. Mbyllja e llogarisë dhe ndërprerja e shërbimeve me kërkesë të Klientit 9
13.3. Mbyllja e llogarisë për personat e vdekur 9
14.0. PËRGJEGJËSITË DHE TË DREJTAT 9
14.1. Përgjegjësitë dhe të drejtat e Bankës 9
14.2. Përgjegjësit dhe detyrat e klientit 9
14.3. Vonesa në njoftim 9
15.0. FSDK 9
16.0. KLIENTËT ME SHTETËSI AMERIKANE - FATCA 9
17.0. ANKESA DHE KOMUNIKIMI 10
18.0. KOMUNIKIMI I NDRYSHIMEVE 10
19.0. HYRJA NË FUQI E KUSHTEVE TË PËRGJITHSHME TË AFARIZMIT TË BANKËS 10

1.0. QËLLIMI

Qëllimi i këtyre kushteve të përgjithshme është rregullimi i raportit kontraktual në mes të Bankës dhe Klientit lidhur me të gjitha shërbimet dhe produktet e Bankës. Këto kushte janë detyruese për klientët dhe të njëjtat duhet të lexohen me kujdes para se klientët të nënshkruajnë çfarëdo kontrate me Bankën.

Këto kushte lidhen në mes të Banka Ekonomike Sh.A. me adresë në rr. "Nëna Terezë", p.n., 10000 Prishtinë, me numër të regjistrimit të biznesit 70177683 dhe me numër fiskal 600106779 (në tekstin e mëposhtëm referohet si "Banka"), dhe personave fizikë dhe juridikë që dëshirojnë të krijojnë marrëdhënie afariste me Bankën (në tekstin e mëposhtëm referuar si "Klienti" apo "klientët").

Me nënshkrimin e këtyre kushteve, Klienti pranon që ka hyrë në raport kontraktual me Bankën dhe i njëjti i pranon të gjitha drejtat dhe detyrimet që dalin nga këto kushte dhe çfarëdo kushti tjetër të veçantë për produkte dhe shërbime të veçanta.

Banka mban të drejtën e ndryshimit të këtyre kushteve, dhe kushteve të tjera plotësuese në përputhje me politikat e brendshme të Bankës si dhe ligjet dhe aktet nënligjiore në fuqi.

Për këto ndryshime Banka do të i njoftojë klientët sipas kushteve të cekura në këtë dokument.

2.0. FUSHËVEPRIMI

"Kushtet e Përgjithshme të Afarizmit të Bankës" është dokument i cili përcakton kushtet për shërbimet dhe produktet e Bankës, përgjegjësitë e Bankës dhe të Klientit, të drejtën e ankesës dhe shumë kushte të tjera të specifikuara në vijim të këtij dokumenti.
Një marrëveshje për shërbime dhe produkte të Bankës nuk mund të aprovohet nëse është në kundërshtim me "Kushtet e Përgjithshme të Afarizmit të Bankës".

3.0. PËRDORIMI I LLOGARIVE

Klienti është i obliguar që t'i përdorë llogaritë dhe shërbimet bankare për qëllime personale apo afariste vetëm për veprimtari që janë të ligjshme në Republikën e Kosovës. Klienti mund të hapë llogari në përputhje me normat ligjore, politikën afariste të Bankës dhe "Kushtet e Përgjithshme të Afarizmit të Bankës".
Identiteti i personit që hap llogari konstatohet nga dokumentet valide personale, të lëshuara nga organet kompetente të shtetit përkatëse, në pajtim me aplikacionin.

3.1. Llojet e llogarive

3.1.1. Llogaria rrjedhëse

Llogaria rrjedhëse është llogari bazike e klientit të cilën klienti mund ta përdor për çdo transaksion personal dhe apo biznesor duke përfshirë tërheqjen e parave të gatshme, urdhërpagesat e ndryshme dhe të gjitha produktet dhe shërbimet e Bankës që klienti zgjedh për t'i shfrytëzuar, do të jenë të lidhura me këtë llogari. Llogaria rrjedhëse e klientit mbetet aktive gjatë marrëdhënies afariste dhe nuk mund të mbyllet deri sa të jenë të përfunduara të gjitha detyrimet dhe obligimet e bankës dhe klientit. Në momentin e hapjes së llogarisë rrjedhëse plotësohet dhe nënshkruhet aplikacioni nga të dy palët me të gjitha informatat e nevojshme që merren nga klienti. Për këtë lloj të llogarisë klienti paguan tarifën mujore për menaxhim të llogarisë në bazë të çmimores së bankës.Në kuadër të llogarisë rrjedhëse klientët mund të shfrytëzojnë edhe disa lloje të pakove, të cilat janë grupim i disa produkteve dhe shërbimeve bankare që kanë tarifë mujore fikse, e shpalosur kjo në cmimoren zyrtare të bankës.Këto pako janë dizajnuar për të përmbushur të gjitha kërkesat dhe nevojat bankare të klientëve duke shfyrtëzuar disa produkte në pako me çmim më të favorshem sesa shfrytëzimi i produkteve veçmas.

3.1.2. Llogaria me shërbime bazike

Llogaria e pagesave me shërbime bazike është një lloj i kufizuar i llogarisë rrjedhëse dhe ofrohet ekskluzivisht në valutën Euro.Llogaria me shërbime bazike ofrohet vetëm për klientë individual të cilët nuk kanë ndonjë llogari tjetër të pagesave me shërbime bazike në asnjë Bankë tjetër në Republikën e Kosovës. Me llogarinë e pagesave me shërbime bazike, klienti ka të drejtë të realizojë deponime dhe tërheqje nga llogaria e pagesave përmes transaksioneve në kuadër të fondeve që i ka në llogari të pagesave. Klienti gjithashtu ka të drejtë të realizojë debitime direkte, transaksione të pagesave përmes kartelës, përfshirë pagesat online në internet brenda Kosovës; transferet e kreditit brenda Bankës, përfshirë urdhëresat automatike, aty ku është e mundur në bankomatë (ATM), në sportelet e Bankës, apo në platformat elektronike. Të gjitha këto shërbime janë të përfshira në pakon bazike që kanë tarife mujore fikse e shpalosur kjo në cmimoren zyrtare të bankës. Ne kuader te pakos bazike nuk ofrohen produktet kreditore si kredi, mbiterheqje apo produkt tjeter kredie qe ofron Banka

3.1.3. Llogaria e kursimit

Llogaria e kursimit është llogari e depozitave me interes. Llogaria e kursimit mund të përdoret për tërheqje të fondeve në dispozicion. Numri apo depozitat dhe tërheqjet nga llogaria e kursimit nuk janë të kufizuara, dhe të gjitha llojet e transaksioneve realizohen përmes llogarisë rrjedhëse. Banka rezervon të drejtën e ndryshimit të normës së interesit, tarifave dhe kushteve të marrëveshjes në çdo kohë, duke i njoftuar klientët paraprakisht në përputhje me afate e përcaktuara në këtë dokument.

3.1.4. Llogaria rrjedhëse për fëmijë

Llogaria rrjedhëse për fëmijë është llogari e hapur nga njëri apo të dy prindërit ose kujdestari ligjor i fëmijës.
Llogaria hapet në emër të fëmijës mirëpo menaxhohet nga ana e prindit (prindërve) ose përfaqësuesit ligjor. Llogaria rrjedhëse për fëmijë përfshin klientët deri në moshën 18 vjeç. Numri apo depozitat dhe tërheqjet nga llogaria rrjedhëse nuk janë të kufizuara, dhe të gjitha llojet e transaksioneve realizohen përmes llogarisë rrjedhëse të fëmijës. Në momentin e hapjes së llogarisë rrjedhëse nënshkruhet formulari në mes të Bankës dhe prindit/kujdestarit ligjor. Banka rezervon të drejtën e ndryshimit të tarifave dhe kushteve të marrëveshjes në çdo kohë, duke i njoftuar klientët paraprakisht në përputhje me afatet e përcaktuara në këtë dokument.

3.1.5. Llogaria e kursimit për fëmijë

Llogaria e kursimit për fëmijë është llogari e depozitave me interes, e hapur nga njëri apo të dy prindërit ose kujdestari ligjor i fëmijës.
Llogaria hapet në emër të fëmijës mirëpo menaxhohet nga ana e prindit (prindërve) ose përfaqësuesit ligjor. Llogaria e kursimit për fëmijë përfshin klientët deri në moshën 18 vjeç. Numri apo depozitat dhe tërheqjet nga llogaria e kursimit nuk janë të kufizuara, dhe të gjitha llojet e transaksioneve realizohen përmes llogarisë rrjedhëse. Në momentin e hapjes së llogarisë së kursimit nënshkruhet marrëveshja e kursimit në mes të Bankës dhe prindit/kujdestarit ligjor. Banka rezervon të drejtën e ndryshimit të normës së interesit, tarifave dhe kushteve të marrëveshjes në çdo kohë, duke i njoftuar klientët paraprakisht në përputhje me afatet e përcaktuara në këtë dokument. Kjo llogari nuk mund të hapet pa hapur paraprakisht llogarinë rrjedhëse për fëmijë.

3.1.6. Llogaria Flexi Depozit

Llogaria Flexi Depozit është e destinuar për depozitimin e mjeteve, me përfitim të interesit bankar-fleksibil. Depozituesit i mundësohet përmes llogarisë rrjedhëse të deponojë mjete në këtë llogari, në çdo kohë dhe në çfarëdo shume, ndërsa që të përfitojë interes, kufiri i vlerës është i përcaktuar në marrëveshjen që lidhet mes Klientit dhe Bankës, për të cilat informohet Klienti kur aplikon. Klienti mund të ngarkohet me tarifa për çdo debitim në përputhje me marrëveshjen për Flexi Depozit. Nga llogaria Flexi klienti mund të realizojë tërheqje por do të aplikohet tarifë shtesë siç përcaktohet në çmimoren e bankës.
Në momentin e hapjes së llogarisë Flexi Depozit nënshkruhet marrëveshja në mes të Bankës dhe Klientit. Banka rezervon të drejtën e ndryshimit të normës së interesit, tarifave dhe kushteve të marrëveshjes në çdo kohë, duke i njoftuar klientët paraprakisht në përputhje me afatet e përcaktuara në këtë dokument.

3.1.7. Llogaria e depozitës me afat

Llogaria e depozitës me afat është e destinuar për depozitimin e mjeteve me afat të caktuar kohor, sipas marrëveshjes së nënshkruar në mes Bankës dhe Klientit.
Norma e interesit do të mbetet e njëjtë gjatë kohëzgjatjes së kësaj marrëveshje. Banka llogarit dhe paguan interesin nga dita e mjeteve te afatizuara deri ne diten e maturimit, në bazë të normave të interesit të caktuara me Çmimoren e Bankës.
Nëse Depozituesi nuk paraqet kërkesën me shkrim apo nuk e njofton Bankën për mosvazhdimin e kontratës së paku 1 (një) ditë para afatit të maturimit, Banka konsideron se ekziston pëlqimi i Depozituesit për vazhdimin e Marrëveshjes në mënyrë automatike, me normën e interesit bankar të caktuar me Çmimoren e Bankës që vlen në ditën e vazhdimit të Marrëveshjes për afatizimin e depozitave. Interesi i fituar deri në ditën e maturimit do të bartet në llogarinë rrjedhëse të Depozituesit.
Depozituesi nuk mund t'i tërheqë depozitat e afatizuara para datës së maturimit të parashikuar me marrëveshje. Në raste të veçanta, Banka mund të lejojë që marrëveshja të ndërpritet, mirëpo Depozituesi duhet të paraqesë kërkesën me shkrim së paku 1 (një) ditë më herët, dhe në këtë rast të tërheqjes së depozitave para datës së maturimit, Klientit i llogaritet interesi sipas kushteve të përcaktuara në marrëveshje.

3.1.8. Interesi në mjetet e depozituara, norma efektive e interesit dhe tatimi në burim

Interesi në mjetet e depozituara do të llogaritet në baza ditore duke i'u referuar vitit me 365/366 ditë dhe numrit aktual të ditëve që shumëzohet me normën e interesit vjetor të periudhës përkatëse. Klienti mund të ngarkohet me tarifa për çdo debitim në përputhje me marrëveshjen për Flexi Depozit. Banka merr përsipër të përmbushë urdhërpagesa nga llogaria, në shuma jo më të mëdha se gjendja e llogarisë rrjedhëse. Klienti është i obliguar që të deponojë fonde të mjaftueshme për pagesën e mirëmbajtjes mujore dhe të tarifave të shërbimeve tjera. Banka gëzon të drejtën që t'i debitojë të gjitha llogaritë e Klientit për pagesën e tarifave të Bankës ose obligimeve të papaguara. Banka aplikon interes në llogari sipas kushteve të punës të interesit në fuqi të publikuar prej saj në Çmimore në faqen zyrtare www.bekonomike.com, si dhe në degët e saj.
Norma efektive e interesit në llogari llogaritet sipas rregullores së BQK-së "Rregullore për normën efektive të interesit dhe kërkesat për shpalosje" dhe shpaloset në kontratën ndërmjet Bankës dhe Klientit.

038 500 500
info@bekonomike.com
www.bekonomike.com

Tatimi në burim llogaritet sipas normës së përcaktuar nga autoriteti fiskal dhe të gjitha shpenzimet barten nga Klienti.

4.0. PERSONAT E AUTORIZUAR

Klienti mund të lidhë kontrata dhe të kryejë punë të tjera juridike edhe me përfaqësues, përmes autorizimit.
Kontrata të cilën e lidhë përfaqësuesi në emër të Klientit dhe në kuadër të autorizimeve të veta e obligon drejtpërdrejt Klientin.
Përfaqësuesi i autorizuar nuk mund të bëjë bartjen e autorizimeve të veta tek personi i tretë.
Përfaqësuesi mund t'i ndërmarrë vetëm ato punë juridike për ndërmarrjen e të cilave i është dhënë autorizimi.
Është përgjegjësi e Klientit që të njoftojë Bankën në mënyrë të qartë për autorizimet dhe për çdo person që autorizohet nga ana e tij. Banka nuk është përgjegjëse për gabimet ose dështimet që dalin për shkak se autorizimet apo udhëzimet e nënshkruesit nuk janë të qarta.
Klienti dhe personi i autorizuar janë të obliguar që së bashku të jenë prezentë në Bankë me rastin e autorizimit, ose Bankës duhet t'i prezantojnë aktin noterial të autorizimit.
Është përgjegjësi e Klientit që ta njoftojë Bankën për revokimin e autorizimit. Banka do të vazhdojë të realizojë transaksione nga përfaqësuesi derisa nuk merr njoftim nga Klienti se autorizimi i përfaqësuesit është revokuar.
I autorizuari obligohet që ta njoftojë Bankën për çfarëdo rrethane që do të ndikonte në shuarjen/revokimin/pavlefshmërinë e autorizimit dhe do të jetë përgjegjës për çfarëdo dëmi të shkaktuar si pasojë e realizimit të transaksioneve pas paraqitjes së këtyre rrethanave.

5.0. SHËRBIMET DHE PRODUKTET BANKARE ELEKTRONIKE

Banka ofron shërbime dhe produkte elektronike si alternativë e kryerjes së shërbimeve bankare.
Në momentin e aplikimit apo përdorimit të këtyre shërbimeve specifike, Klienti mund të ketë edhe kushte tjera në formularin e aplikimit të shërbimeve dhe produkteve për të cilat Klienti do të informohet, dhe pastaj do të nënshkruhet kontrata për shfrytëzimin e produktit.
Shërbime elektronike bankare janë shërbimet bankare të realizuara online, si: mobile banking, e-banking etj., që kryhen nëpërmjet mjeteve elektronike të komunikimit. Këto shërbime bankare mund të qasen nga klientët e Bankës nëpërmjet përdorimit të mjeteve të ndryshme të komunikimit, si p.sh. telefoni, celulari, terminalet ose kompjuterët personalë etj.

5.1. E-banking

E-banking është një shërbim që ia mundëson mbajtësit të realizojë transaksione të ndryshme bankare, përfshirë urdhërpagesat, duke përdorur internetin. Përmes kësaj platforme, Klientit i mundësohet qasja në llogarinë e tij dhe kryerja e shërbimeve bankare përmes internetit, 24 orë në ditë, 7 ditë në javë.
Gjithashtu klientët e biznesit mund të ngarkojne të dhënat e pagesave masive perfshirë edhe pagat e punonjësve, të cilat pas verifikimit dhe aprovimit realizohen drejt llogarive te duhura bankare, e cila ndihmon klientët e biznesit të përpunojnë pagesat masive me lehtësi dhe në mënyrë efikase.

5.2. SMS Mbushja

Është shërbim elektronik ku Klienti, duke e shfrytëzuar SMS-in nga operatorët e licencuar në Republikën e Kosovës, ka qasje në llogarinë e tij në Bankën Ekonomike, ku përmes SMS-it mund të mbushë telefonin mobil, t'u dërgojë mbushje të tjerëve si dhe t'i paguajë të gjitha shërbimet tjera (internet, kabllovik dhe shërbime tjera të operatorit). Mesazhet duhet të përmbajnë të dhënat e kërkuara nga shitësi. Klienti është përgjegjës për sigurinë dhe qasjen në telefona të autorizuar dhe për saktësinë e të dhënave të transmetuara. Në veçanti, Klientit i ngarkohet tarifa e shërbimit dhe tarifat nëse shtypet gabimisht numri, ku si rezultat kreditin e merr një përfitues tjetër. Nëse telefoni humbet, vidhet ose dyshohet që se përdoret në mënyrë të paautorizuar, Klienti duhet ta njoftojë Qendrën e Thirrjeve menjëherë.

5.3. SMS Info

SMS Info i mundëson Klientit që të jetë i informuar për bilancin e llogarisë përmes telefonit mobil, duket telefonuar në numrin e përcaktuar nga Banka për këtë shërbim.

5.4. SMS Njoftimi

SMS Njoftimi i mundëson Klientit që të jetë i informuar mbi ndryshimet e bilancit në llogarinë e tij përmes telefonit mobil, ku për çdo transaksion në llogarinë e tij do të njoftohet me anë të SMS-it. Klienti për këtë shërbim mund të caktojë limit të shumës së transaksionit që dëshiron të njoftohet.

5.5. Pasqyra e llogarisë

Banka u siguron klientëve të saj që të gjitha debitimet dhe kreditimet në llogarinë e tyre do të regjistrohen në pasqyrën e llogarisë me të gjitha detajet e transaksioneve dhe se do jenë në dispozicion të klientëve në çdo kohë.

5.6. Ofertat speciale

Ofertat speciale ose zbritjet mund të vendosen për një periudhë të kufizuar kohore. Për ofertat speciale, Banka do të zgjedhë formën e komunikimit nëpërmjet kanaleve të komunikimit të Bankës. Banka, për arsye të kërkesës së tregut/infrastrukturës ligjore ose procedurave të brendshme, mund ta zvogëlojë ose ta shkurtojë periudhën e vlefshmërisë, ose ta kufizojë ofertën. Klienti mund të marrë informata për shërbimet dhe produktet bankare në të gjitha degët e bankës, duke kontaktuar Qendrën e Thirrjeve në numrat e tel. +383 (0)38 500 500 dhe +383 (0)49 733 322, ose në faqen e internetit të Bankës Ekonomike www.bekonomike.com.

5.7. Shërbimi i investimit në instrumentet financiare brenda dhe jashtë vendit për klient

Banka Ekonomike u mundëson klientëve të saj tregtimin e instrumenteve financiare në mbi 15 bursa të huaja, duke përfshirë bursat më të mëdha në botë si Bursa e Nju Jorkut, NASDAQ, Bursa e Londrës, Bursa e Frankfurtit, Bursa e Tokios dhe të tjera.
Në të gjitha këto bursa, klientët do të jenë në gjendje të investojnë në aksione, obligacione dhe fonde të tregtuara në bursë (ETF).
Të gjitha urdhërat për investime në instrumente financiare përmes Bankes Ekonomike klientet do të mund t'i dergojnë përmes e-mailit, telefonit. Para çdo investimi klienti do të pranon nga banka listen e tarifave qe do ngarkohen kundrejt ketij sherbimi për klient, si dhe, një broshurë me disa informata të përgjithshme lidhur me instrumentet financiare.
Klientet permes Bankes Ekonomike mund të investojne gjithashtu në Letrat me vlere(Bono Thesari dhe Obligacione) të cilat emetohen nga Qeveria e Republikës së Kosovës.

6.0. DEBIT DHE KREDIT KARTELAT, SI DHE TERMINALET POS dhe ATM

Banka Ekonomike mund të ofrojë për klientët e saj kartela Master Card Debit, Visa Electron, Master Card Kredit, Visa Classic dhe Visa Gold.

6.1. Debit Kartelat

Debit Kartela, MasterCard Debit dhe Visa Electron janë kartela që i lejojnë klientët të kenë qasje në llogarinë e tyre rrjedhëse, për të kryer blerje me fondet e disponueshme në llogari rrjedhëse ne pika te ndryshme te shitjes, per te bere blerje online përmes internetit dhe/ose për të tërhequr/deponuar para të gatshme.
Me debit kartele klienti mund të tërheq në çdo bankomat (ATM) të Bankës Ekonomike, si dhe në çdo bankomat (ATM) tjetër ku shfaqet logo MasterCard dhe Visa, në Republikën e Kosovës dhe në mbarë botën varësisht nga lloji i kartelës përkatëse.Ndërsa, kartelat lokale debitore (kartela per kategorine e pensionerve) kanë të lejuar funksionin e tërheqjes, ndrrimit të pinit dhe kërkesën për bilanc vetëm në ATM-at e Bankës Ekonomike dhe nuk mund të përdoren në ATM-a dhe POS terminale e bankave tjera si dhe për blerje në internet. Nëse debit kartela përdoren jashtë Kosovës do të zbatohen rregulloret dhe kushtet e institucioneve ndërkombëtare Mastercard dhe Visa. Gjithashtu, do të zbatohen normat e këmbimit të valutës së atyre institucioneve. Me përdorimin e debit kartelës ne terminalet e POS dhe bankomat jashtë Republikës se Kosovës aplikohet tarifa sipas cmimores. Kartelat MasterCard Debit, dhe Visa Electron, gjithashtu janë të përshtatshme për blerje në çdo pikëshitje (POS terminal) në Kosovë dhe kudo në botë, ku shfaqet logo e këtyre kartelave. Akti i shtypjes së një PIN kodi duke përdorur bankomatin ose pajisjen e shitësit e ka efektin e nënshkrimit ligjërisht obligues dhe autorizon Bankën ta bëjë pagesën nga llogaria e tij. Shitësi gjithashtu mund të kërkojë të verifikojë identitetin e klientit. Debit kartelat poashtu kane te integruar funksionin e blerjes pa kontakt qe nenkupton deri e shume te caktuar nga sistemi i pagesave (MasterCard dhe VISA) ne POS terminale kudo mund te realizojne blerje pa perdorim PIN-i. Çdo transaksion që bën klienti me kartelë pasqyrohet në gjendjen e llogarisë së tij, duke e mundësuar kështu verifikimin e çdo transaksioni.
Banka mund t'ia ndërpresë përdorimin e kartelës klientit në çdo kohë nëse shkelen keto kushte te përgjithshme të afarizimti, kontrata e debit karteles, ne rastet kur keqpërdoret kartela, nuk paguhen tarifat etj. Transaksionet e realizuara me kartelë bëjnë debitimin e llogarisë menjëherë në kohë reale, derisa paraqitja e transaksioneve ne historiat te llogarisë bëhet ne ditët vijuese të punës për llojet e transaksioneve që realizohen në terminale të Bankës. Disa lloje të transaksioneve që realizohen në terminale jashtë bankës si dhe jashtë vendit pasqyrimi i transaksionit në llogari të klientit mund të bëhet me vonesë, varësisht nga prezantimi i transaksionit nga banka pranuese përkatëse

6.2. Kredit Kartelat

Kartelat e kreditit janë kartela që i japin muKredit Kartelat janë kartela që i japin mundësinë klientit të përdorë një linjë krediti. Nëpërmjet saj klienti mund të bëjë blerje dhe/ose të tërheqë para të gatshme në një limit të paracaktuar nga banka. Banka ndal nje tarife sipas cmimores për tërheqje te parave te gatshme. Vlera e lejuar e kreditit duhet të shlyhet e plotë, në fund të një periudhe të caktuar ose mund të shlyhet pjesërisht dhe e shtyrë në kohë, në përputhje me termat e përcaktuar në kontratën mbi lejimin dhe shfrytëzimin e kredit kartelës.
Nëse klienti nuk i kryen obligimet e kërkuara në mënyrë të plotë ose nuk ka fonde të mjaftueshme në datën e caktuar për arkëtim të borxhit, pas kësaj date, banka mund të përdorë të gjitha mjetet në llogaritë e tij për të shlyer borxhin në kredit kartelën e tij. Interesi i rregullt, kamatëvonesa dhe çdo shpenzim tjetër për shkak te mos pagimit te borxhit do ti ngarkohen klientit komfor kushteve te përcaktuara ne kontrate per lejimin dhe shfrytëzimin e kredit karteles.
Kartela Mastercard, Visa Classic dhe Visa Gold, Visa Platinum gjithashtu janë të dedikuara për blerje në çdo pike shitje (POS terminal) në Kosovë dhe kudo nëpër botë, ku shfaqet logo MasterCard apo Visa. Klienti mund të tërheq në çdo bankomat (ATM) të Bankës Ekonomike, ose në çdo bankomat (ATM) tjetër ku shfaqet logo Mastercard/ dhe Visa, në Kosovë si dhe

038 500 500
info@bekonomike.com
www.bekonomike.com

në mbarë botën.
Me kredit kartelë sikurse edhe me debit kartelë klienti gjithashtu mund të bëjë blerje mallrash apo shërbimesh përmes internetit.

6.3. ATM

Banka Ekonomike ju ofron të gjithë klientëve të saj një rrjet të gjerë të bankomatëve në të gjithë territorin e Republikës së Kosovës, duke u mundësuar qasje në çdo kohë në llogarinë e tyre, përfshirë këtu pasqyrimin e llogarisë, deponimin dhe tërheqjen e mjeteve sipas limiteve të përcaktuara nga Banka.

6.4. POS terminalet

POS terminali apo pika e shitjes "point of sale" mundësohet nga Banka ndaj Tregtarit për realizim të pagesave përmes kartelave bankare. Për qëllime të këtij shfrytëzimi, Tregtari do t'i paguajë Bankës (i) mirëmbajtjen për secilin POS Terminal që ka nën shfrytëzim dhe (ii) provizion për secilin transaksion ne baze te cmimores së bankës . Për shmangie të çfarëdo dyshimi, Tregtari duhet të hapë llogari bankare si parakusht për shfrytëzimin e POS Terminalëve të Bankës.

6.5. Njoftimi për humbje, vjedhje apo shfrytëzim të paautorizuar

Nëse klienti vëren se kartela e tij është humbur, vjedhur apo shfrytëzuar pa autorizim ai duhet që sa më shpejtë të lajmërojë degën më të afërt të Bankës Ekonomike apo të njoftojë Qendrën e Thirrjeve në numrin e telefonit +383 (0)38 500 500 ose në telefon mobil +383 (0)49 733 322 në mënyrë që kartela e klientit të de-aktivizohet për të mos u shfrytëzuar apo keqpërdorur nga pala e tretë.
Nëse klienti e gjen kartelën e humbur e cila tashmë është de-aktivizuar, për të aktivizuar të njëjtën kartelë, nëse tashmë nuk është anuluar tërësisht nga Banka, klienti duhet përsëri të lajmërojë degën më të afërt të Bankës apo të kërkojë riaktivizim përmes Qendrës së Thirrjeve.
Nëse kartela Mastercard Debit / Visa Debit është humbur, vjedhur, konfiskuar, dëmtuar ose keqpërdorur në ndonjë mënyrë tjetër, POSEDUESI I KARTELËS duhet ta informoj BANKËN në numrin e telefonit 00383 38 500 500 dhe/apo +383 49/733322 apo përmes numrit të tel. pa pagesë 080050505., në mënyrë që të bllokohet kartela.
POSEDUESI I KARTELËS ose ndonjë person tjetër i autorizuar nga ai, duhet poashtu ta parashtroj një kërkesë me shkrim për bllokimin e kartelës Mastercard Debit / Visa Debit brenda 48 orëve pasi të ketë njoftuar bankën në telefonin e Qendrës së thirrjeve / kujdesi ndaj klientëve.
Nëse nuk veprohet në këtë mënyrë, atëherë BANKA nuk është përgjegjëse për transaksionet që do të bëhen përmes kartelës.

Nëse POSEDUESI I KARTELËS harron PIN kodin, ai/ajo mund të kërkojë PIN kodin e ri duke paguar tarifën sipas Afateve dhe Kushteve të Përgjithshme si dhe Tarifave të BANKËS. Kjo tarifë, që vjen si rezultat i kërkimit të PIN kodit të ri të kartelës MasterCard Debit/Visa Debit zbritet nga llogaria. Në rast se fondet nuk janë të mjaftueshme ndalesat mund të zbriten nga llogaritë tjera. Nëse llogaritë të tjera nuk janë të mjaftueshme atëherë poseduesi i kartelës MasterCard Debit / Visa Debit duhet t`a kryej obligimin në një afat prej 30 (tridhjetë) ditëve

Shfrytëzuesi i kartelave obligohet që:

- Të përdorë kartelën në përputhje me kushtet dhe afatet e përcaktuara në këtë kontratë;
- Të mbajë privat PIN-in ose fjalëkalimin dhe te dhenat e shtypura ne kartele pershi edhe kodin CVV dhe t'i marrë të gjitha masat për të mos lejuar qasjen e një personi tjetër;
- Të njoftojë menjëherë Bankën në rast se ndodh të paktën një nga ngjarjet në vijim: kartela shkatërrohet, keqpërdoret, humbet, vidhet, falsifikohet, apo kopjohet, vëren ndonjë abuzim, mashtrim në lidhje me PIN-in/fjalëkalimin që bën të mundur qasjen e personave të tretë në kartelë; transaksioni me kartelë është kryer pa marrë miratimin nga shfrytëzuesi; vëren një gabim apo mospërputhje në ekstraktin e lëshuar nga Banka.
- Të mos e shkruajë PIN-in/fjalëkalimin ose CVV e tij në një vend të dukshëm dhe që i jep mundësi një personi të tretë ta lexojë atë;
- Shfrytëzuesi obligohet dhe është përgjegjës që t'ia paguajë Bankës të gjitha tarifat që Banka i ngarkon lidhur me shfrytëzimin e kartelës;
- T'i ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme të sigurisë, në mënyrë që kompjuteri, telefoni i mençur, dhe të gjitha pajisjet tjera që mund të përdoren për të bërë pagesa me kartelë përmes internetit të jenë të sigurta nga çdo infektim, ndërhyrje kibernetike apo qasje e paautorizuar nga personat e tretë apo palët keqdashëse. Banka nuk merr ndonjë përgjegjësi në rast të kompromettimit të kartelës së shfrytëzuesit me fajin e tij.
- Të jetë i vetëdijshëm dhe i vëmendshëm në futjen e të dhënave të kartelës bankare në faqet e internetit duke u siguruar që ato faqe janë legjitime, të besueshme dhe se i përmbajnë të gjitha aspektet e sigurisë.
- Të mbajë privat PIN-in, kodet, fjalëkalimet dhe t'i ndërmarrë të gjitha masat tjera të sigurisë gjatë shfrytëzimit të kartelës, në asnjë rast mos të lejojë fotokopjimin e kartelës edhe kur kjo kërkohet nga organe serioze.

Përveç obligimeve te specifikuara në këto kushte, Klienti është përgjegjës të respektojë secilën nga kushtet dhe afatet e specifikuara në këto kushte në kontratat e kartelave dhe në të gjitha dokumentet tjera të Bankës, të cilat e rregullojnë çështjen e shfrytëzimit të kartelave, si dhe ligjet dhe aktet nënligjore të aplikueshme.

7.0. TRANSAKSIONET NË LLOGARI

7.1. Paraja e gatshme

Për mbrojtjen e Klientit dhe për të parandaluar mashtrimin, Banka cakton një limit ditor ose limit të numrit të transaksioneve për shumën e parave që mund të tërhiqet nga bankomati brenda ditës. Po ashtu, Klienti mund të bëjë tërheqje të parave të gatshme në degë me ose pa paralajmërim sipas limiteve të përcaktuara në Çmimoren në fuqi.
Klienti, duke i ofruar Bankës paratë e tij, deklaron dhe konfirmon se prejardhja e tyre është e ligjshme.
Banka mund t'i konfiskojë të hollat në qoftë se dyshon në origjinalitetin e tyre. Kjo vlen pavarësisht nëse Klienti ka qenë në dijeni ose jo. Banka nuk është përgjegjëse për gabime, duke përfshirë këtu edhe për çdo dëm të reputacionit apo çdo humbje që mund të pësojë Klienti.
Në qoftë se transaksioni është bërë në llogarinë e Klientit gabimisht, atëherë Banka rezervon të drejtën ta tërheqë ose ta kthejë mbrapa në pajtueshmëri me ligjet në fuqi. Nëse Klienti i ka shpenzuar fondet, atëherë ai është i obliguar që këto fonde t'ia kthejë Bankës, për çka Klienti do të njoftohet paraprakisht.

7.2. Këmbimi i valutave

Banka Ekonomike ua mundëson klientëve të saj shërbimin për këmbimet valutore në mënyrë që klientët të kenë mundësi t'i përmbushin nevojat e tyre. Gjatë kryerjes së transaksionit të pagesës, i cili kërkon konvertim të valutave, përdoret kursi (i blerjes/i shitjes) që është i vlefshëm në kohën reale të kryerjes së transaksionit të pagesës. Transaksionet në valutë të huaj kryhen në bazë të tarifave standarde dhe tarifës së këmbimit në datën përkatëse kur Klienti kryen transaksion të tillë personalisht në ndonjë nga degët e Bankës, ose për transaksionet me e-banking.
Për transaksionet në shuma më të mëdha, klientëve mund t'u ofrohet kurs special i këmbimit. Ndryshimet e kursit të këmbimit hynë në fuqi menjëherë dhe pa njoftim paraprak të poseduesit të llogarisë. Kurset e këmbimit që ne i përdorim janë norma të ndryshueshme të këmbimit të cilat ndryshojnë vazhdimisht gjatë gjithë ditës dhe ndikohen nga lëvizjet në tregjet valutore. Gjatë përdorimit të kartelave ndërkombëtare Mastercard dhe Visa jashtë vendit dhe në valutë të huaj jo Euro, përllogaritja e shumës së transaksionit nga valuta e huaj në Euro bëhet sipas kursit të këmbimit të përcaktuar nga institucionet ndërkombëtare Mastercard dhe Visa.
Shuma e transaksionit të autorizuar në valutë jo Euro mund të ndryshojë nga shuma e transaksionit financiar që procesohet nëpërmjet sistemit të pagesave për shkak të ndryshimit të mundshëm të kursit të këmbimit nga data e autorizimit të transaksionit dhe datës së pranimit të transaksionit financiar, të aplikuar nga Mastercard, Visa ose cilado kompani tjetër e licencuar për procesim të transaksioneve me kartela.

7.3. Urdhërpagesat

Banka e ekzekuton një urdhërpagesë të iniciuar nga paguesi brenda afatit kohor të përcaktuar sipas rregulloreve në fuqi por, megjithatë, në asnjë rast Banka nuk do të ekzekutojë urdhërpagesën nëse nuk ka fonde të mjaftueshme në llogarinë prej nga do të barten fondet.
Klienti duhet që t'ia ofrojë Bankës të gjitha detajet e nevojshme për të realizuar një transfer.
Banka Ekonomike është përgjegjëse vetëm për ekzekutimin e transfereve që realizohen nga Banka ndërsa nuk mban përgjegjësi për çfarëdo vonese apo gabimi që mund të ndodhë nga bankat apo institucionet e tjera relevante.
Për të gjitha llojet e transfereve aplikohen tarifa të cilat janë të publikuara në Çmimoren e Bankës.
Për transferet ndërkombëtare, në rast se Klientit i është kthyer prapa transferi për çfarëdo arsye, shuma e kthyer mund të jetë më e vogël se shuma e dërguar, jo vetëm për shkak të tarifave (që do të vazhdojnë të ngarkohen) por edhe për shkak të dallimeve të kursit të këmbimit.
Limiti i pagesave: shuma që mund të transferohet përmes një transaksioni përmes e-banking është e limituar deri në një vlerë të caktuar të përcaktuar sipas kontratës së e-banking.

7.3.1. Transferet brenda bankës

Një transfer konsiderohet brenda Bankës në qoftë se dërguesi dhe përfituesi i mjeteve janë klientë të Bankës Ekonomike.

7.3.2. Transferet vendore

Banka Ekonomike ua mundëson klientëve të saj që të kryejnë transfere tek përfituesi i cili ka një llogari të hapur në ndonjërën nga bankat që operojnë në Republikën e Kosovës.
Të gjitha transferet vendore realizohen vetëm në valutën Euro.
Koha e prerjes e procesimit të transfereve vendore është në përputhje me sesionet e përcaktuara nga Banka Qendrore e Kosovës.
Transferet e pranuara pas skadimit të sesioneve trajtohen si të pranuara dhe procesohen ditën e ardhshme të punës.

7.3.3. Transferet ndërkombëtare

Banka Ekonomike mund të realizojë transfere ndërkombëtare të parave përmes bankave të saja korrespodente.
Të gjitha transferet ndërkombëtare mund të realizohen në valutat Euro, USD, CHF dhe GBP.

Për realizimin e transfereve, Banka kërkon informacion nga klientët se ku do të transferohen mjetet. Ky informacion i kërkuar duhet të jetë i saktë, dhe Klienti, me nënshkrimin e formularit të transferit, konfirmon vërtetësinë dhe saktësinë e këtyre informacioneve.

7.3.4. Refuzimi i transfereve

Banka ka të drejtë t'i refuzojë transferet të cilat janë të plotësuara në mënyrë jo të rregullt, për kryerjen e të cilave nuk ka mbulesë të mjaftueshme, apo në rast se transferi hyn në kategori të transaksioneve të ndaluara nga Banka. Banka nuk ka obligim për dëmin eventual që do t'i krijohej Klientit për moskryerjen e transfereve për arsye të cekura më lart.
Me rastin e refuzimit, Banka e informon Klientin për arsyet e refuzimit. Nënshkrimi i formularit të transferit nga Klienti në asnjë mënyrë nuk nënkupton që transferi me doemos do të realizohet pasi transferi do të kontrollohet nga Banka para dërgimit.

7.3.5. Urdhërpagesa automatike (Standing Order)

Urdhërpagesa automatike (Standing Order) ia mundëson Klientit të bëjë pagesa të ndryshme fikse për një periudhë të caktuar kohore, duke transferuar mjetet automatikisht prej llogarisë rrjedhëse në llogarinë e kursimit, si dhe pagesa tjera fikse.
Urdhërpagesa është e vlefshme dhe zbatohet në tërësi sipas kushteve të paraqitura në të, dhe për ndërprerjen e kësaj urdhërpagese para afatit Klienti është i obliguar që ta njoftojë Bankën me shkrim duke e plotësuar formularin për ndërprerjen e urdhërpagesës automatike. Po ashtu, Klienti mund të bëjë ndërprerjen e urdhërpagesës automatike përmes e-banking në rastet kur është aktivizuar përmes e-banking.
Në rast se llogaria bllokohet me urdhër nga autoritet publike, nuk mund të realizohet asnjë nga transaksionet në atë llogari.

7.3.6. Pagesat e faturave (Tax)

Pagesat e faturave janë të gjitha ato fatura të lëshuara nga institucionet e ndryshme buxhetore (ministritë, komunat, Administrata Tatimore e Kosovës, Trusti Pensional i Kosovës etj.) të cilat domosdoshmërisht përmbajnë një reference unike të quajtur UNIREF. Leximi i këtyre faturave bëhet përmes lexuesve të posaçëm të bar kodeve.

7.3.7. Kos Giro

Kos Giro shfrytëzohet për pagesat e faturave të shërbimeve publike dhe pagesat e rregullta periodike.
Kos Giro përdoret për kryerjen e pagesave utilitare si: KESCO, PTK, KUR, shërbimi doganor si dhe kompanitë e sigurimeve.
Faturaështë standarde dhe leximi bëhet përmes lexuesve të posaçëm të bar kodeve.

7.3.8. Debitimi Direkt

Debitimi Direkt është një produkt i lansuar në sistemin bankar me qëllim të lehtësimit dhe shpejtimit të pagesave të rregullta si rryma, uji, telefoni etj. Debitimi Direkt është produkt i cili ia mundëson Klientit që pagesat e rregullta mujore t'i realizojë në mënyre automatike.
Deri më tani, në skemën e Debitimit Direkt janë përfshirë: KESCO, PTK, Ujësjellësi, Termokos etj.

7.3.9. Anulimi i urdhërpagesave

Nëse Klienti dëshiron që një transfer, debitim direkt ose urdhërpagesë automatike të anulohet pasi që mjetet kanë dalë nga Banka, atëherë Banka do të përpiqet që t'i kthejë mjetet, por nuk mund të garantojnë kthimin e mjeteve.

7.3.10. Procesimi i pagave dhe pagesave masive

Banka ofron procesimin e pagave dhe pagesave masive brenda në Bankë në mënyrë që të lehtësojë klientëve procesimin e pagesave masive dhe pagave të punonjësve në mënyrë të shpejtë dhe efikase duke aplikuar një tarifë e cila është e publikuar në cmimore të Bankës.

8.0. PRODUKTET KREDITORE

Banka ofron produkte te ndryshme kreditore për klientët e saj bazuar ne nevojat e tyre. Këto produkte ndahen ne produkte për biznese dhe individ. Destinimi i këtyre produkteve përcaktohet varësisht prej produktit te përcaktuar nga klientët dhe i njëjti specifikohet ne marrëveshjet e veçanta për secilin produkt.

Llojet e produkteve kreditore qe ofron banka per biznese janë:
Kreditë ju ofrohen klientëve për nevoja biznesit ku klientit i lejohet shuma e caktuara e mjeteve dhe i cili detyrohet qe obligimin ta kthej me keste sipas kushteve te përcaktuara ne marrëveshje dhe planin e pagesave.

Kreditë me këste mund të ofrohen me strukture afat-shkurtë apo afatgjatë. Kryesisht, këstet janë të barabarta gjatë gjithë afatit të kredisë. Bizneset të cilat janë të afektuara nga rrjedha e parase si pasoje esezonalitetit mund të aplikohen edhe këste jo të rregullta apo edhe grejs periudhë (grejs standart – pagesa vetëm të interesit të rregullt pa paguar principal dhe grejs të plotë – nuk paguhet as interes as principal).
Për aktivitete bujqësore ose për financimet e projekteve kur pagesat kryesisht rrjedhin pas përfundimit të projekteve preferohet të aplikohen këste jo të rregullta apo edhe grejs periudha.
Kreditë e mbuluara me depozita: Kreditë ju ofrohen klientëve për nevoja biznesit ku klientit i lejohet shuma e caktuara e mjeteve dhe i cili detyrohet qe obligimin ta kthej me keste sipas kushteve te përcaktuara ne marrëveshje dhe planin e pagesave. Specifik e këtij produkti kreditor është qe kredia është e mbuluar me depozit.
Mbitërheqja për biznese është një produkt fleksibil afatshkurtër kreditor që i lejon klientit te krijoj bilanc negativ në llogarinë e tij deri në limitin e përcaktuar dhe është e lidhur me qarkullimin aktual ose potencial përmes llogarisë rrjedhëse te klientit. Klienti paguan interes vetëm per shumen e shfrytëzuar te bilancit negativ.
Linjë kreditore, është një produkt kreditor i cili lejohet për financimin e nevojave të kapitalit punues për një periudhë të caktuar kohore. Ky lloj produkti i lejon klientit të krijoj bilanc negativ në llogarinë e tij deri në limitin e përcaktuar për të financuar kryesisht blerje në periudha të ndryshme sezonale.
Huazimi është një produkt afat shkurtër kreditor qe u dedikohet klientëve me veprimtari sezonale për qëllim te financimit të projekteve të veçanta të cilat pritet të gjenerojnë fluks më të madh të të hyrave në një periudhe të caktuar. Plani i pagesës tek huazimet mund të lidhet si marrëveshje e pagesës vetëm të interesit deri në fund të maturitetit kur paguhet edhe principali ose pagesa me një këst të principalit dhe interesit në afatin e maturimit.
Garancionet bankare, janë instrument sigurie të lëshuara nga banka. Ku banka merr obligim për pagesën e shumes se garantuar te parave.

Letër kreditë: jane dokumente sipas të cilave ne pajtohemi të paguajmë fonde te një bankë kur ajo bankë konfirmon se të gjitha dokumentet e kërkuara në letrën e kredi janë paraqitur te ajo gjatë periudhës së deklaruar të vlefshmërisë së letërkredisë dhe janë ne përputhje me kushtet e let r kredis. Detyrimi ynë është vetëm për të verifikuar pajtueshmerin e dokumenteve me kushtet e Leter kredisë. Ne nuk marrim asnjë përgjegjësi dhe nuk jemi përgjegjës në lidhje me cilësinë, disponueshmërinë, dorëzimin e mallrave ose shërbimeve.

Kreditë për individë ju ofrohen klientëve te cilët nuk janë te angazhuar ne aktivitet e biznesit dhe qëllimi i kredisë është për nevoja personale.
Llojet e produkteve kreditore qe ofron banka për individ janë:
Kreditë konsumuese – Janë kredi për individ qe ju ofrohen klientëve për nevoja personale, renovim apo ndërtim dhe klientit i lejohet shuma e caktuara e mjeteve dhe i cili detyrohet qe obligimin ta kthej me këste sipas kushteve te përcaktuara ne marrëveshje dhe planin e pagesave.
Kreditë Hipotekare Residenciale janë kredi te cilat ju ofrohen klientëve për financim te blerjes së paluejtshmërive qe përdoren si siguri për këtë lloj te kredisë.
Kreditë Hipotekare janë kredi të cilat ju ofrohen klientëve për financimin të blerjes së paluejtshmërive dhe për të cilat kërkohet kolateral/hipotekë shtësë.
Mbitërheqja për individë është një produkt fleksibil afatshkurtër qe i lejon klientit të krijoj bilanc negative në llogarinë e tij deri në limitin e përcaktuar. Klienti mund të përdorë mbitërheqjen gjatë tërë kohës deri në skadim të afatit të maturimit.
Banka detyrohet që ti ofrojë informacione klientit për produktet kreditore që ofron Banka si dhe kushtet për kredi, duke i dhënë në formë të shtypur dokumentacionin e kërkuar për produktin kreditor që përcaktohet klienti. Klienti për të marrë kredi, më parë duhet të plotësojë disa kritere, një nga të cilat është hapja e llogarisë rrjedhëse.
Pas kompletimit të dokumentacionit nga ana e klientit, Banka shqyrton kërkesën kreditore dhe në rastin e aprovimit të kredisë, Banka i ofron klientit kontratën për kredi bankare, në të cilën janë përcaktuar kushtet dhe tarifat në lidhje me atë produkt kreditor, kësti mujor, data e këstit mujor, norma vjetore e interesit, norma efektive e interesit, afati i produktit kreditor si dhe kamat vonesa.
Plani i amortizimit është pjesë e integruar e kontratës për kredi.
Çdo shpenzim tjetër jashtë Bankës, në lidhje me kontratën e kredisë, si tarifat e mbulimit të hipotekës në institucionet përkatëse, marrëveshjes së pengut, i përkasin klientit. Banka ka te drejt te bllokoj llogarit bankare ne rast te vonesave ne ekspozimet e ndryshme kreditore sipas procedurave te brendshme te Bankës.
Lizingu financiar: nënkupton një marrëdhënie financiare në mes të lizingdhënësit dhe lizingmarrësit në të cilën palët hyjnë në një marrëveshje me shkrim. Kjo marrëveshje jep të drejtën e posedimit dhe përdorimit të Asetit (objekt lizingu) për periudhën e caktuar të kohës në këmbim të pagesës nga lizingmarrësi në bazë të kësteve të përcaktuara. E drejta e asetit të lizingut kalon menjëherë nga lizingdhënësi te lizingmarrësi në fund të kohëzgjatjes së lizingut.Për këtë produktë vet aseti I cili financohet është prone juridike e bankës dhe nuk ka nevojë per kolateral apo hipotek shtesë.
Llojet e produkteve kreditore që ofron banka me Lizing janë:
Lizing Financiar për patundshmëri mund të përdoret për qëllime të banimit (shtëpi apo banesa) dhe për qëllime të afarizmit (lokale apo prona për shfrytëzim afarist/zyre). Me këtë produkt mund të subjektet juridike dhe personat fizik, duke përfshirë klientët individual jo rezident.
Lizing Financiar për Vetura – Banka financon vetura për nevoja të afarizmit për subjektet juridike dhe për nevoja personale. Financimi i veturave me këtë produkt mund të bëhet për vetura ë reja, të përdorura dhe pajisje motorike.
Lizing Financiar për Pajisje janë financimet e pajisjeve për nevoja te afarizmit të subjektit juridik.
Financim i stokut është produkt i cili i ofrohet autosalloneve për financim te stokut (vetura).

038 500 500 info@bekonomike.com www.bekonomike.com

Shitje teknike dhe kthim në Lizing produkt i cili i ofrohet subjektit juridik, biznes i cili ka blerë osë importuar asetin që do kthehet në lizing.

8.1.1. Instrumentet e sigurimit të produkteve kreditore

Klienti është i obliguar që, në bazë të kërkesës së Bankës, të ofrojë instrumente adekuate të sigurimit për borxhin ndaj Bankës. Lidhur me këtë, Banka mund të kërkojë prona të paluajtshme si hipotekë, sende të luajtshme si peng (këtu përfshihen edhe llogaritë bankare), apo bashkëhuamarrës dhe garantues.
Për të gjitha instrumentet e sigurisë të specifikuara më lart, paraprakisht nënshkruhet marrëveshje e veçantë në mes të Bankës dhe Klientit, ku parashihen të gjitha të drejtat dhe obligimet për marrëdhënien kontraktuale konkrete.
Në rast se Klienti nuk i paguan obligimet që dalin nga marrëveshjet e produkteve kreditore, Banka do t'i iniciojë të gjitha procedurat e nevojshme gjyqësore/përmbarimore dhe të tjera për t'i realizuar të drejtat e saj për kthim të borxhit, përfshirë por duke mos u kufizuar në: inicimin e procedurës për sekuestrim të pengut dhe hipotekës, bllokimin dhe sekuestrimin e mjeteve financiare nga llogaritë e Klientit/Kredimarrësit, Bashkëhuamarrësit dhe Garantuesit dhe çfarëdo mase tjetër ligjore.

9.0. URDHËRAT NGA AUTORITETET LOKALE

Banka është e obliguar t'u nënshtrohet kërkesave/urdhërave nga ana e autoriteteve kompetente, siç janë gjykatat, përmbaruesit privatë. ATK-ja dhe/apo institucionet e ngjashme, në përputhje me ligjet në fuqi në Republikën e Kosovës. Përmes këtyre kërkesave/urdhrave, Bankës mund t'i kërkohet zbulimi i të dhënave financiare, bllokimi i llogarive, dhe/apo transferimi i fondeve nga llogaritë e klientëve. Banka nuk do të jetë përgjegjëse për veprimet e ndërmarra duke zbatuar kërkesat/urdhrat e tillë, edhe nëse urdhrat e lëshuara kanë gabime në lidhje me ligjin në fuqi ose faktet nuk janë verifikuar me saktësi, apo ndonjë detyrim tjetër në lidhje me to. Klienti pajtohet se Banka nuk është përgjegjëse dhe se nuk do të kërkojë asgjë nga Banka, pra, Klienti do ta trajtojë çdo çështje me autoritetet përkatëse.

10.0.TARIFAT DHE PROVIZIONET

Klienti pajtohet t'i paguajë të gjitha tarifat për shërbimet bankare sipas Çmimores në fuqi, të cilat mund të ndryshojnë me njoftim paraprak tek Klienti.

Pas aplikimit për produktin apo shërbimin e Bankës, Klienti informohet për të gjitha tarifat/provizionet që do të aplikohen për shërbime, dhe pajtohet që të njëjtat të realizohen nga llogaria përkatëse e Klientit pa ndonjë njoftim shtesë, përveç nëse parashihet ndryshe.

Me kërkese të Klientit për modifikim të të dhënave në transfer ndërkombëtar aplikohet tarifë sipas Çmimores së Bankës të publikuar si dhe shpenzimet e bankave korrespodente.

Mund të ketë tarifa të palëve të treta ose të zbatohen në llogarinë e Klientit me urdhër të autoriteteve publike kompetente, siç është mbajtja në burim e tatimeve, urdhrat nga autoritetet e taksave ose urdhrat gjyqësorë. Banka nuk do të jetë përgjegjëse nëse detyrimi apo shumat që dalin nga urdhëresat apo ndalesat e ndryshme janë të gabuara. Klienti duhet ta shqyrtojë këtë çështje me autoritetet përkatëse. Me kërkesën e Klientit, kur lejohet me ligj, Banka do ta informojë për urdhrin përkatës.

Tarifat standarde mund të merren në të gjitha degët e Bankës Ekonomike, në faqen tonë të internetit, apo në Qendrën e Thirrjeve-Call Center, apo duke dërguar email në info@bekonomike.com.

11.0.PRIVATËSIA DHE TË DHËNAT PERSONALE

Mbrojtja e të dhënave personale dhe privatësia e individit është njëra nga përgjegjësitë tona thelbësore. Ne jemi të përkushtuar në transparencë lidhur me përpunimin e të dhënave tuaja personale. Ne i marrim të dhënat e juaja personale drejtëpërdrejtë nga ju apo nga personat që ju keni autorizuar të ju përfaqësojnë në momentin e ofrimit të shërbimeve tona financiare dhe gjithmonë kujdesemi se kemi një bazë ligjore për përpunimin e të dhënave tuaja personale. Përpunimi i të dhënave tuaja personale bëhet duke respektuar parimet, përgjegjësitë dhe të drejtat të cilat dalin nga dispozitat e Ligji nr.06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.
Ne gjithmonë përpunojmë të dhënat e juaja personale nëse zbatohet njëri nga kriteret e mëposhtëme:
-Nëse ju keni dhënë pëlqimin tuaj me shkrim për përpunimin e të dhënave personale për një ose më shumë qëllime specifike;
-Përpunimi i të dhënave personale është i domosdoshëm për përmbushjen e një kontrate, në të cilën ju jeni palë kontraktuese ose për të ndërmarrë veprimet lidhur me kërkesën tuaj para lidhjes së kontratës;
-Nëse përpunimi i të dhënave personale është i domosdoshëm pë respektimin e obligimit ligjor, të cilit i nënshtrohet Banka;
- Nëse përpunimi i të dhënave personale është i domosdoshëm për mbrojtjen e interesave jetike të subjektit të të dhënave ose personave të tjerë fizikë;
-Nëse përpunimi i të dhënave personale është i domosdoshëm për kryerjen e një detyre me interes publik ose për ushtrimin e autoritetit zyrtar që i është dhënë Bankës;

-Nëse përpunimi i të dhënave personale është i domosdoshëm për qëllime të interesave legjitime të ushtruara nga Banka ose pala e tretë, përveç kur këto interesa tejkalohen nga interesat apo të drejtat dhe liritë themelore të subjektit të të dhënave që kërkon mbrojtjen e të dhënave personale, veçanërisht nëse subjekti i të dhënave është fëmijë.

Është obligim i klientit të sigurojë se të gjitha të dhënat që i ofron bankës janë të sakta, të fundit dhe të plota. Klienti duhet t'i mbajë te dhënat e tij/saj te përditësuara dhe është i obliguar që në rast të ndryshimit të të dhënave të tij/saj t'a njoftoj bankën duke vizituar ndonjërën nga degët tona.
Me nënshkrimin e këtij dokumenti ju pajtoheni që banka mund t'i përdor dhe t'i përpunojë të dhënat e juaja personale për qëllim të ofrimit të shërbimeve, zhvillimit, përmirësimit të tyre si dhe të jemi në përputhshmëri me rregullatorët dhe legjislacionin që aplikohen në Republikën e Kosovës. Informatat që i mbanë banka për ju do të ruhen edhe pasi qe klienti e ka ndërprerë marrëdhënien kontraktuale me Bankën Ekonomike, për aq kohë sa kërkohet për të përmbushur detyrimet ligjore sipas legjislacionit përkatës në fuqi për të ruajtur të dhënat e juaja personale.
Banka Ekonomike ju siguron që të gjitha te dhënat te cilat i shkëmbeni me bankën do të trajtohen me standarde te larta te sigurisë dhe konfidencialitetit dhe ato nuk do të shpalosen me palët që nuk janë të ndërlidhura me proceset dhe operimin e bankës përveç rasteve kur parashikohet ndryshe në këto kushte dhe me akteret shtetëror ne qoftë se jemi të detyruar që të bëjmë shpalosjen e të dhënave të juaja me urdhër të organeve kompetente dhe sipas legjislacionit të aplikueshëm në Republikën e Kosovës. Banka përpunon të dhënat e juaja personale duke zbatuar masat adekuate teknike dhe organizative psh të gjithë punonjësit e Bankës të cilët ju i ofroni të dhënat e juaja personale kanë mbajtur trajnimin lidhur me funksionin e mbrojtjes së të dhënave personale dhe kanë nënshkruar marrëveshje të konfidencialitetit për mos zbulimin e informatave të marra edhe pas përfundimit të marrdhënies së punës.
Banka Ekonomike do të zbulojë të dhënat e juaja një pale të tretë vetëm nëse ekziston një bazë e ligjshme për zbuluar ato dhe në varësi të shërbimeve që Banka i ofron. Banka mund të shpalosë dhe/apo transferojë të dhënat e juaja personale në përputhje me Ligjin nr.06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale duke përfshirë por duke mos u kufizuar:
-Autoriteteve: Autoriteteve relevante rregullative dhe mbikëqyrëse publike kombëtare dhe ndërkombëtare si psh Banka Qëndrore e Kosovës, Administrata Tatimore e Kosovës, Njësia e Inteligjencës Financiare, IRS-së, agjencitë zyrtare përkatëse, autoriteteve financiare ose gjyqësore sipas kërkesave zyrtare dhe në masën e lejuar me ligj.
Palët e treta: Subjekte juridike për të cilat Banka ka nevojë për të kryer shërbime për bankën si Visa dhe Mastercard, procesues të kartelave të kreditit, banka korrespodente të vendit dhe të huaja, përfitues tuaj, SWIFT, sistemet vendore të kliringut, regjistri i pengut pranë MTI dhe regjistri i hipotekës nga zyrat kadastrale, institucione të tjera kreditore ose financiare.
Të tjera: Kontraktues të bankës që ofrojnë shërbime të teknologjisë së informacionit dhe zhvillimin e softuerëve, kontraktues që ofrojnë shërbime të cilat e ndihmojnë bankën për të përmbushur interesat legjitime si psh kërkesat për të kthyer borxhin, kompanitë për vlerësimin e pronave, këshilltarët tanë të jashtëm ligjor, auditorët, noterë, përmbarues, kontraktues të tjerë të cilët veprojnë për dhe sipas udhëzimeve të bankës, me të cilët banka krijon një marrëveshje të veçantë lidhur me përpunimin e të dhënave personale.
Banka Ekonomike mund të transferojë të dhënat e juaja personale edhe në shtete të treta apo organizata ndërkombëtare në vendet të cilat ofrojnë nivel të duhur të mbrojtes së të dhënave personale sipas listës së publikuar nga Agjencia për Informim dhe Privatësi.
Banka Ekonomike ju siguron se transferimi i të dhënave personale do të bëhet në pajtueshmëri me dispozita e Ligjit nr.06/L-82 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.
Asnjë person tjetër përveç zyrtarit bankar apo personit të emëruar nga ana e klientit që mban llogarinë, apo vet pronari i llogarisë nuk mund të ketë qasje nëpërmjet një kanali elektronik në informacionet lidhur me transferin e mjeteve, transaksionet apo llogarinë bankare.
Banka Ekonomike mund t'i ruaj inqizimet e bisedave telefonike dhe e-mailat që ju i dërgoni për shkaqe të kontrollimit te cilësisë, ofrimit te shërbimeve dhe sigurisë. Poashtu banka bën vëzhgime përmes sistemit me kamerë të objekteve të saj të brendshme dhe jashtme si dhe të bankomateve për arsye të sigurisë dhe të mosmarrëveshjeve të ndryshme që mund të shfaqen. Këto të dhëna janë konfidenciale dhe do të përdoren vetëm për nevoja te bankës, përveç në qoftë se jemi te detyruar që te bëjmë shpalosjen e këtyre te dhënave me urdhër te organeve kompetente ne përputhje me legjislacionin e aplikueshëm ne Republikën e Kosovës.
Banka mund t'i përdor të dhënat personale të klientit për qëllim të marketingut të drejtpërdrejt ku do të njoftohen për ofertat më të reja përmes shërbimeve postare, thirrjeve telefonike, postës elektronike, sms ose mënyrave tjera të komunikimit në qoftë se ju vetëm e keni dhënë pëlqimin me shkrim për këtë shërbim. Ne rast se ju nuk dëshironi që të pranoni më reklamime nga banka, atëherë ju duhet që t'a vizitoni ndonjërën nga degët e bankës apo ta vizitoni faqen tonë në internet përkatësisht http://www.bekonomike.com/sq/%C3%87regjistrohu-nga-me- sazhet-promocionale nga ku mund të ç'regjistroheni nga ky shërbim.
Ju si klient keni këto të drejta të garantuara edhe me Ligjin nr.06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale:
- E drejta juaj për qasje në të dhënat personale: keni të drejtën të kërkoni një kopje për të dhënat që banka mban për ju
- E drejta juaj për korrigjim të të dhënave personale: keni të drejtën të kërkoni nga ne të korigjojmë dhe përditësojmë informacionin i cili është i pasaktë apo i paplotë
- E drejta juaj për të fshirë të dhënat personale ('E drejta për t'u harruar'): keni të drejtën të kërkoni që ne të i fshijmë të dhënat e juaja personale, kjo e drejtë aplikohet në rrethana të caktuara.
- E drejta juaj për kufizim të përpunimit të të dhënave personale: Ju keni të drejtë të na kërkoni të kufizojmë përpunimin e informacionit tuaj personal, sipas rrethanave të caktuar.
- E drejta juaj për të kundërshtuar përpunimin e të dhënave personale: Ju keni të drejtë të kundërshtoni përpunimi e të dhënave personale në lidhje me ju, sipas rrethanave të caktuara.
- E drejta juaj për transferimin e të dhënave personale: Kjo e drejtë vlen vetëm për të dhënat personale që ju na keni dhënë dhe ne i përpunojmë ato vetëm me pëlqimin tuaj. Ju keni të drejtën që të kërkoni që ne të transferojmë të dhënat personale që na keni dhënë tek një palë e tretë.
- E drejta juaj për të paraqitur ankesë tek Agjencia për Informim dhe Privatësi: Ju në çdo kohë keni të drejtën për të parashtruar ankesën tuaj tek Agjencioni për Informim dhe Privatësi në qoftë se mendoni se Banka nuk është duke respektuar të drejtat e juaja që i keni të garantuara me me Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.
Ju mund të kontaktoni Zyrtarin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale lidhur me ushtrimin e të drejtave tuaja apo çështjeve të tjera relevante lidhur me privatësinë dhe përpunimin e të

038 500 500
info@bekonomike.com
www.bekonomike.com

dhënave personale duke dërguar kërkesën me shkrim në postën elektronike dataprotection@bekonomike.com apo përmes postës në adresën Banka Ekonomike SH.A. Sheshi Nëna Terezë p.n., 10000, Prishtinë, Kosovë. Nga Banka nuk do të ju kërkohet asnjë tarifë shtesë lidhur me kërkesën tuaj për ushtrimin e të drejtave tuaja sa i përket përpunimit të të dhënave personale.

12.0.PRONARI KRYESOR PËRFITUES

Ligji kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit i obligon bankat që të kryejnë një sërë detyrimesh të identifikimit të Klientit. Një obligim i tillë konsiston në identifikimin e pronarit kryesor përfitues të klientëve të tyre. Çdo pronar i biznesit që hap llogari biznesi në Bankën Ekonomike duhet të plotësojë dhe firmosë këtë formular, duke e bërë në këtë mënyrë më të lehtë identifikimin e pronarit kryesor por, edhe nëse pronari i biznesit nuk është pronar përfitues i këtij biznesi, ai megjithatë duhet të identifikohet dhe duhet të plotësohet formulari.

13.0.MBYLLJA E LLOGARISË

13.1. Mbyllja e llogarisë së Klientit - ndërprerja e shërbimit-/eve

Banka mund te mbyll menjeher llogarite dhe pastaj te njoftoje klientin per mbyllje te llogarise:

- Klienti ka shkelur "Kushtet e përgjithshme të afarizmit të Bankës";
- Banka dyshon me arsye se klienti ka dhënë informata të falsifikuara;
- Banka dyshon me arsye se llogaria e klientit po përdoret për qëllime ilegale ose për të lehtësuar krimin;
- Klienti sillet në mënyrë kërcënuese ose të dhunshme ndaj personelit të Bankës;
- Banka beson që është e nevojshme të mbroj veten ose grupin e vet nga humbjet materiale ose kostot që nuk janë për shkak të fajit të saj ose të mbroj stabilitetin e tregjeve financiare të Kosovës ose tregjeve ndërkombëtare financiare ose sistemeve bankare;
- Nëse kërkohet nga Departamenti i Pajtueshmërisë për PPP/FT
- Nëse kërkohet me ligj ose nga gjykata; (nëse me ligj kërkohet përditësimi i llogarisë atëherë klienti informohet 30 ditë paraprakisht që nëse nuk I përditëson te dhenat , llogaria e tij mbyllet)
- Nëse Klienti nuk e përdorë llogarinë ose shërbimin përkatës për një periudhë të caktuar kohore prej 12 muajve, Banka mban të drejtën e mbylljes së llogarisë apo të ndërprerjes së shërbimit përkatës.

Banka obligohet që në afatin prej 30 ditëve të informojë Klientin për mbylljen e llogarisë së tij apo për përfundimin e ndonjë shërbimi.

Pavarësisht atyre që u thanë më lart, Banka mundet që në çdo kohë, pa dhënë ndonjë sqarim, të mbyllë llogarinë e Klientit dhe të përfundojë raportin kontraktual me të, duke respektuar afatin 30-ditor të njoftimit të specifikuar më lart.

13.2. Mbyllja e llogarisë dhe ndërprerja e shërbimeve me kërkesë tëKlientit

Klienti mundet në çdo kohë, pa dhënë ndonjë sqarim, të mbyllë llogarinë e tij dhe të përfundojë raportin kontraktual me Bankën, me kusht që paraprakisht t'i ketë mbyllur të gjitha detyrimet që ka ndaj Bankës.
Është përgjegjësi e Klientit që t'i njoftojë palët e treta, duke përfshirë edhe çdo person që paguan në atë llogari, për mbylljen e llogarisë.
Në rastet kur llogaria është e bllokuar nga institucionet sipas ligjit, llogaria nuk mund të mbyllet edhe nëse paraqitet kërkesa për mbyllje nga Klienti.

13.3. Mbyllja e llogarisë për personat e vdekur

Lidhur me llogaritë e personave të vdekur që kanë mjete, ato trashëgohen nga pasardhësit e tyre, mbi bazën e aktit të trashëgimisë (testamentit, aktit noterial apo vendimit gjyqësor të trashëgimisë).
Në rastet e llogarive të zbrazëta, ato mbyllen në momentin e marrjes së njoftimit për vdekjen e personit në bazë të certifikatës së vdekjes, por nëse nuk ka ndonjë njoftim, atëherë duhet zbatuar e njëjta procedurë si për llogaritë pasive.

14.0.PËRGJEGJËSITË DHE TË DREJTAT

14.1. Përgjegjësitë dhe të drejtat e Bankës

Banka është përgjegjëse që:

- Të regjistrojë në mënyrë korrekte dhe të evidentojë në llogaritë bankare të mbajtësit çdo transaksion të kryer nga Klienti;
- Të sigurojë shmangien/eliminimin e pengesave teknike apo mangësive të tjera për kryerjen e transaksioneve dhe shfrytëzimin e shërbimeve;
- Të ruajë regjistrimet për një periudhë kohe të përcaktuar me ligjet në fuqi në mënyrë që të mundësohet identifikimi i transaksioneve të realizuara dhe korrigjimi i gabimeve në rastet e përcaktuara në kontratë;
- T'ia ofrojë Klientit mundësinë e njoftimit në lidhje me humbjen, vjedhjen, keqpërdorimin apo shkatërrimin e kartelave, gjatë 24/7 orëve përmes mjeteve të komunikimit në dispozicion;
  Banka ka të drejte që të ndërhyjë në llogarinë e Klientit, pa pëlqimin e tij, në këto raste:
- Për të bllokuar një llogari dhe/apo ekzekutuar një pagesë në bazë të vendimit fuqiplotë e ekzekutues të gjykatës apo të ndonjë organi tjetër kompetent, ose në rastet tjera që parashikohen me ligj.
- Banka mund të ndërhyjë në llogarinë e Klientit edhe në rast të korrigjimit të transaksioneve të gabuara (debit/kredit) që mund të ndodhin gjatë operimeve ditore.
- Banka po ashtu mund të ndërhyjë në llogarinë e Klientit edhe në raste të ndryshme në përputhje me ligjet dhe rregulloret në fuqi.

Banka nuk është përgjegjëse ndaj Klientit të saj nëse dështimi për të kryer një transfer të fondeve është shkaktuar apo ka rezultuar nga forca madhore apo rrethanat tjera që nuk mund të kontrollohen nga Banka, si p.sh. sulmet kibernetike përtej nivelit të sigurisë të ofruar nga banka, rastet e luftës, konfliktit, protestat, ndërhyrjet nga autoritetet qeveritare etj., me kusht që nuk ka munguar gjithë kujdesi dhe vigjilenca e arsyeshme e Bankës.
Banka e informon Klientin se kalkulatorët në faqen e internetit të Bankës janë thjesht për qëllime reference dhe nuk do të thotë se Banka është pajtuar ose pajtohet me ndonjë produkt ose kredi bankare, interes ose afat të maturimit nëpërmjet llogaritjeve të bëra në faqen e internetit të Bankës; për këtë arsye, Banka nuk do të jetë përgjegjëse nëse Klienti i keqkupton të dhënat e paraqitura në kalkulatorin në faqen e internetit.

14.2. Përgjegjësit dhe detyrat e klientit

Klienti është i obligua që çdo produkt dhe shërbim të lejuar nga Banka ta shfrytëzojë vetëm për qëllimin për të cilin i është lejuar shërbimi apo produkti. Në cilindo rast, çdo produkt dhe shërbim i lejuar nga Banka duhet të jetë në përputhje të plotë me të gjitha ligjet dhe aktet nënligjore të aplikueshme në Republikën e Kosovës, si dhe rregullat e brendshme të Bankës.
Klienti është i obliguar ta njoftojë Bankën për çdo gabim në pasqyrën e llogarisë së tij, apo për ndonjë transaksion të paautorizuar në lidhje me produktet dhe shërbimet që Klienti i ka në shfrytëzim. Për qëllimet e këtij neni, gabimi në pasqyrën e llogarisë përfshin:

- transferin e pasaktë në llogarinë e Klientit apo nga llogaria e tij; apo
- shtimin apo heqjen në pasqyrën periodike të një transferi të fondeve që ndikon në llogarinë e Klientit.

Klienti nuk është përgjegjës për dëmet që rezultojnë nga një transaksion i paautorizuar që ndodhë pasi të ketë njoftuar Bankën se kartela është humbur, keqpërdorur a vjedhur, apo se kodi i sigurisë ose qasjes ose pajisjeve tjera elektronike që mundësojnë miratimin elektronik është shkelur.

14.3. Vonesa në njoftim

Në rastet e vonesës së njoftimit nga ana e Klientit për kartelën e humbur, të keqpërdorur apo për vjedhjen e kartelës, apo për dikë tjetër që e di PIN-in e kartelës, Banka nuk do të mbajë përgjegjësi për dëmin që mund të rezultojë nga transaksionet e paautorizuara, dhe Klienti është përgjegjës për dëmin që ka ndodhur deri në momentin e njoftimit të Bankës, përveç për atë pjesë të dëmit të pësuar në cilëndo ditë që tejkalon limitin e transaksionit ditor të kartelës, mjetit tjetër apo llogarisë.

15.0.FSDK

Klienti i ka të siguruara llogaritë e tij të depozitave në të gjitha bankat që janë anëtare të FSDK-së deri në shumën maksimale të përcaktuar nga Fondi i Sigurimit të Depozitave të Kosovës, dhe kjo shumë do të rritet çdo herë sipas përcaktimit të FSDK-së. Për shembull: një depozitues i siguruar që ka llogari në dy banka anëtare (p.sh. banka A dhe banka B), i ka të siguruara depozitat e veta në ato dy banka, respektivisht në bankën A: deri në €5.000 (euro); dhe në bankën B: deri në €5.000 (euro). Produktet e zakonshme të depozitave në banka të cilat janë të siguruara nga FSDK-ja janë depozitat rrjedhëse (llogaritë rrjedhëse), depozitat e kursimeve dhe depozitat e afatizuara. Për informatat e tjera rreth FSDK-së mund të informoheni në faqen e internetit www. fsdk.org apo përmes numrit kontaktues +383 38 610 355.

16.0.KLIENTËT ME SHTETËSI AMERIKANE - FATCA

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 05/L-013 për Ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës për të Përmirësuar Pajtueshmërinë e Rregulloreve Tatimore në Nivel Ndërkombëtar dhe Zbatimin e Rregulloreve FACTA (Akti për Pajtueshmëri Tatimore për Llogaritë e Huaja Foreign Account Tax Compliance Act - FACTA), të gjithë klientët që dëshirojnë të hapin llogari ose ta përdorin ndonjë shërbim të Bankës janë të obliguar që nëse kanë shtetësi amerikane, green card ose janë

taksapagues amerikan janë të obliguar të shpalosin një informatë të tillë.

17.0.ANKESA DHE KOMUNIKIMI

Për çdo produkt dhe shërbim te ofruar klienti ka te drejtë të paraqes reklamacion përkatësisht Ankesë në njësinë për trajtimin e ankesave duke shfrytëzuar kanalet e përcaktuara për paraqitje të ankesës.
Nga klienti kërkohet të të jap informata të detajuara në lidhje me ankesën.
Trajtimi i Ankesës bëhet komfor Politikes së brendshme për trajtimin e ankesës, e cila është e bazuar në rregulloren për procesin e brendshëm të trajtimit të ankesave të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës
Kohëzgjatja e trajtimit të ankesave do të bëhet në afat prej 15 ditëve, dhe mund të zgjat deri në 30 ditë varësisht prej natyrës së Ankesës, në ç 'rast klienti do të njoftohet për shtyerjen e afatit.

Informacione dhe këshilla për paraqitje të ankeses

Njësia e ankesave ka për detyre të trajtojë të gjitha ankesat e klientëve të saj, përfshirë klientët e mëparshëm dhe ata të cilët pretendojnë të bëhen klient në të ardhmen. Banka Ekonomike ka krijuar kanalet për paraqitjen e ankesave si në vijim:

- përmes Postës së Kosovës në adresën ''Sheshi Nënë Tereza p.n.'' Prishtinë
- përmes postës elektronike në adresën kujdesindajklientit@bekonomike.com
- përmes numrit pa pagesë 0800 50505
  personalisht duke u paraqitur në zyrën më të afërt të Bankës Ekonomike Sh.a.
  përmes telefonit në nr. e telefonit +383 (0)38 500 500 dhe +383 (0)49 733 322
  përmes rrjeteve sociale

Në rast se klienti nuk është i kënaqur me zgjidhjen e propozuar, ka të drejtë të paraqes ankesë në Divizionin e Ankesave të shfrytëzuesve të shërbimeve financiare pranë Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, duke shfrytëzuar një nga kanalet e përcaktuara nga ky divizion apo duke shfrytëzuar gjykatën përkatëse.

18.0.KOMUNIKIMI I NDRYSHIMEVE

Banka mund të bëjë ndryshime në këto kushte, duke përfshirë normat e interesit ose tarifat dhe taksat, si dhe ndryshime në shërbimet bankare, gjë për të cilën ne do ju informojmë me shkrim brenda afateve ligjore dhe ligjeve në fuqi. Ju do të informoheni përmes kanaleve të komunikimit që janë komunikimi përmes postës ose në formë elektronike, ose duke publikuar njoftimin në ndonjërën nga gazetat e Kosovës, ose në faqen tonë zyrtare të internetit, ose në degët/nëndegët e bankës, ose me metoda tjera varësisht prej informatës që do të përmbaj njoftimi.

19.0.HYRJA NË FUQI E KUSHTEVE TË PËRGJITHSHME TË AFARIZMIT TË BANKËS

Këto kushte janë në dispozicion në gjuhën shqipe, serbe dhe angleze. Nëse nuk e keni marrë një kopje në gjuhën tuaj të preferuar, atëherë ju lutemi kërkoni një kopje në degë, ose shkarkojeni nga faqja jonë e internetit www.bekonomike.com.
Këto Kushte të Përgjithshme të Afarizmit të Bankës zbatohen për të gjithë klientët e Bankës Ekonomike (klientët privatë – personat fizikë dhe klientët biznese/entitete – persona juridikë).
Këto Kushte të Përgjithshme të Afarizmit të Bankës janë në fuqi nga data 01.08.2023.

038 500 500
info@bekonomike.com
www.bekonomike.com